



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1600 Prot

Tiranë, më 14/10/2019

REKOMANDIM

Nr. 40, datë 14/10/2019

PËR PROGRAMIN E TRANSPARENCËS
SË AUTORITETIT PUBLIK “AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE”

Në mbështetje të neneve 6, 7 të Ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka kryer monitorimin on-line në faqen zyrtare <http://asd.gov.al/sq/programi-i-transparences/>, të Autoritetit Publik “Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Autoritetet Publike bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, kanë detyrimin të vënë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhen publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publik të këtij informacioni.

Gjithashtu, bazuar në pikën 2 të po të njëjtës dispozitë, në përgatitjen e programit të transparencës, Autoriteti Publik mban parasysh interesin më të mirë të publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e Autoritetit Publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Ky program, vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Autoriteti Publik ndërton dhe rrit transparencën në veprimtarinë e tij institucionale, nëpërmjet përditësimit dhe

pasurimit të vazhdueshëm të Programit të Transparencës, në referencë edhe të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.

Në përputhje me programin e transparencës të miratuar për çdo Autoritet Publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit të përcaktuara në nenin 7 të ligjit të sipërcituar.

Në kuadër të respektimit të detyrimeve të përcaktuara në ligj, u krye monitorimi me qëllim verifikimin e zbatimit të programit të transparencës në faqen zyrtare të Autoritetit Publik. Nga monitorimi rezultoi se, Autoriteti Publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “ASD”, në të cilën programi i transparencës shfaqet si një nën menu.

Nga verifikimi i rubrikave të programit rezultoi se, kategoritë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik pa kërkesë në përputhje me nenin 7 të ligjit, janë pasqyruar në mënyrë jo të plotë në programin e transparencës.

Programi i transparencës duhet të jetë i plotësuar me të gjithë elementët sikurse parashikohet në ligj, si dhe i plotësuar me informacion specifik sipas fushës së veprimtarisë së çdo autoriteti publik.

Në lidhje me monitorimin e kryer Zyra e Komisionerit vlerëson se, problematikat e evidentuara konsistojnë në mosvënien në zbatim të programit të transparencës, në përputhje me modelin e miratuar nga Komisioneri.

Nga monitorimi u konstatua se nuk është publikuar informacioni në përputhje me nenin 7 pika 1 e ligjit, konkretisht për gërmat:

c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;

d) të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë, sipas ligjit, strukturat e pagave për nëpunësit e tjerë, si dhe një përshkrim të procedurave të zgjedhjes, kompetencave dhe detyrave të funksionarëve të lartë të Autoritetit Publik dhe procedurën që ata ndjekin për të marrë vendime;

e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara.

ë) Informacion për procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që

kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik;

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë.

Disa kategori të informacionit publik sipas kërkesave të nenit 7 pika 1 e ligjit, gjenden të publikuara në rubrika të tjera të faqes por nuk janë të ndërlidhura me tabelën e programit (të pa linkuar). Konkretisht si më poshtë:

a) Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik;

b) tekstet e plota të: i) konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; iii) akteve nënligjore; iv) kodeve të sjelljes; v) çdo dokumenti politikash; vi) manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të Autoritetit Publik dhe që prek publikum e gjerë;

c) Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinаторit për të drejtën e informimit;

dh) mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

ë) informacion për procedurat e prokurimit;

f) informacion për shërbimet që Autoriteti Publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

i) regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji (i pa përditësuar);

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh;

l) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga Autoriteti Publik.

Në përfundim, bazuar në provat dhe konstatimet që rezultuan nga monitorimi, u hartua raporti i monitorimit.

Komisioneri vlerëson se, pavarësisht se një pjesë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë është publikuar në faqen zyrtare, Autoriteti Publik duhet ti përmbahet programit model të transparencës të miratuar nga Komisioneri.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7 të Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, shkronjës f) të nenit 31/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar,

REKOMANDOJ :

1. Autoriteti Publik/Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në zbatim të germave a), b), c) të pikës 2 të nenit 4 dhe nenit 5 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të rishikojë/përditësojë programin e transparencës;
2. Autoriteti Publik duhet të pasqyrojë, në programin e transparencës, të gjitha kategoritë e informacionit të detyrueshëm për tu bërë publike në përputhje me nenin 7 të ligjit;
3. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 dhe 2 të këtij Rekomandimi, brenda një afati 90 (nëntëdhjetë) ditë nga momenti i marrjes dijeni;
4. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 18, 19 dhe 20 të ligjit nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 14.10.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi



**Raport monitorimi mbi implementimin e programit të transparencës së Autoritetit Publik/
Agjencisë së Sigurimit të Depozitave – datë 10.10.2019**

Agjencia e Sigurimit të Depozitave, ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në "Transparenca", në linkun: <http://asd.gov.al/sq/programi-i-transparences/>




Nga monitorimi i faqes rezulton se, autoriteti publik ka publikuar në shiritin e menu-së kryesore menu-në “ASD” dhe programi i transparencës shfaqet si një nën menu. Programi i transparencës nuk është i publikuar në përputhje me Programin Model të Transparencës të miratuar sipas Urdhërit nr.14 date 22.01.2015 . Një pjesë e informacionit të detyrueshëm për t’u bërë publik sipas nenit 7 të ligjit, është vendosur dhe në faqen zyrtare të Autoritetit Publik por nuk është nderlidhur me programin.


Kategorie + Informationsquelle publik na Internet	Reas lagore	Documenti / Fotografije	Aditi bazisi pub publikacione	Adresa + publikacione	Struktura organizacije
Prehvatila i struktura organizacije, funkcionalitet dhe datume ne Agjencione	2006 7 / 1 / 2006	Arrestime organizatoreve + struktura dhe funksione ne Krahunet Qendrore te Agjencione	Prehvatime nga struktura Qendrore te Agjencione	Ne faqen e internetit ne Internetin "AND" Struktura Organizatoreve http://and.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Struktura-Organizatoreve.pdf	Komiteti Qendror i Agjencioneve S.A.N.J
Llogje dhe hetimorgane Documenti publikohen	2006 12 / 1 / 2006	Arreste hetimorgane Struktura	Prehvatime nga struktura Qendrore te Agjencione	Ne faqen e internetit ne Internetin "Reas Lagore Llogje dhe Hetimorgane + Dokumentet" http://and.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Reas-Lagore-Llogje-Hetimorgane-Dokumentet.pdf Ne faqen e internetit ne Internetin "Reas Lagore Llogje Hetimorgane dhe Dokumentet" http://and.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Reas-Lagore-Llogje-Hetimorgane-Dokumentet.pdf	Shkronja Qendrore Shkronja Qendrore Shkronja Qendrore
Shkronja Qendrore dhe dokumentet	2006 12 / 1 / 2006	Kodi i Shkronjes Qendrore	Shkronja Qendrore	Ne faqen e internetit ne Internetin "AND" Shkronja Qendrore http://and.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Shkronja-Qendrore.pdf Ne faqen e internetit ne Internetin "Funksione Reporte Qendrore" http://and.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Funksione-Reporte-Qendrore.pdf Ne faqen e internetit ne Internetin "Reas Lagore Shkronja Qendrore" http://and.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Reas-Lagore-Shkronja-Qendrore.pdf	Shkronja Qendrore Shkronja Qendrore Shkronja Qendrore
Informacione per organizimin dhe funksionimin e agjencioneve	2006 12 / 1 / 2006	Funksione Qendrore	Prehvatime nga struktura Qendrore te Agjencione	Ne faqen e internetit ne Internetin "AND" Funksione Qendrore http://and.gov.al/wp-content/uploads/2016/01/Funksione-Qendrore.pdf	Shkronja Qendrore Shkronja Qendrore

Në përputhje me programin e transparencës së miratuar çdo autoritet publik, përgatit paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e informacionit si më poshtë:

7.1.a) *Një përshkrim të strukturës organizative, funksioneve dhe detyrave të autoritetit publik*
Informacioni sipas kësaj kërkesë të ligjit gjendet i publikuar/i linkuar në programin e transparencës së autoritetit.




7.1.b) tekstet e plota: i) të konventave që janë ratifikuar nga Republika e Shqipërisë; ii) të ligjeve; iii) të akteve nënligjore; iv) të kodeve të sjelljes; v) të çdo dokumenti politikash; vi) të manualit ose ndonjë dokument tjetër që ka lidhje me ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik dhe që prek publikun e gjerë. **Informacioni gjendet i publikuar/i linkuar në programin e transparencës së autoritetit;**



7.1c) informacion për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës;



Në programin e transparencës është vendosur linku përkatës i formatit të kërkesës dhe ankesës, por ky link nuk funksionon.


7.1.ç) Të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit; **Informacioni është i publikuar në faqe.**




7.1.dh) Mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit;

Informacioni nuk gjendet i publikuar në faqen e autoritetit. Nga klikimi në linkun përkatës në programin e transparencës, faqja ndërlihet me faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit. Nga kërkimi në faqe rezultojnë e publikuar rezoluta e vitit 2018, si dhe një raport auditimi nga një auditues privat.





e) të dhëna për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara. Informacioni gjendet pjesërisht i publikuar në faqen e autoritetit por jo i ndërlidhur me programin. Nga klikimi në linkun përkatës në programin e transparencës, faqja ndërlidhet me faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.



ë) Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: i) listën e kontratave të lidhura; ii) shumën e kontraktuar; iii) palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, iv) informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;

Informacioni është i publikuar pjesërisht në faqen zyrtare të autoritetit.

Program | Transparenca | 452 | X | Regjistrë - kërkesave dhe përgjigjeve | X | Regjistrë - parashikimeve 2018 | X |

and.gov.al/monitorimi/regjistrë/Llogaritshetevet/publike/Regjistrë-parashikimeve-2018.pdf

Regjistrë-parashikimeve-2018.pdf 1 / 1

Regjistrë i parashikimit të prokurimit publik i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave 2018

Nr	Viti	Titulli i artikullit	Numri i marrëveshjes	Titulli i kontratës (nëse është e mundur, shprehni në mënyrë të qartë)	Vendi i kontratës	Shuma e kontratës	Vlera për secilin	Lidhja procedurës së prokurimit (Mënyra e kontratës dhe koha e kontratës)
1	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
2	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
3	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
4	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
5	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
6	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
7	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
8	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
9	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
10	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
11	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
12	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
13	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
14	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
15	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
16	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
17	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
18	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
19	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
20	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
21	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
22	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
23	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
24	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
25	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
26	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
27	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
28	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
29	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
30	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
31	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
32	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
33	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë
34	2018 (B)	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë	Agjencitë

f) informacion për shërbimet që autoriteti publik i jep publikut, përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit;

Informacioni është i publikuar menu të ndryshme të faqes.

g) çdo mekanizëm dhe procedurë për bërjen e kërkesave dhe ankesave, në lidhje me veprimet ose mosveprimet e autoritetit publik

Informacioni nuk është i publikuar.

gj) çdo mekanizëm apo procedurë, përmes së cilës personat e interesuar mund të paraqesin mendimet e tyre apo të ndikojnë në çfarëdo mënyre tjetër në hartimin e ligjeve, të politikave publike apo ushtrimin e funksioneve të autoritetit publik;

Informacioni nuk është i publikuar në faqen zyrtare të autoritetit.

h) një përshkrim të thjeshtë të sistemit që përdor autoriteti publik për mbajtjen e dokumentacionit, të llojeve, formave të dokumenteve, si dhe të kategorive të informacionit që bëhet publik pa kërkesë; **Informacioni nuk është i publikuar në faqen zyrtare të autoritetit.**

i) **regjistrë i kërkesave dhe përgjigjeve, sipas nenit 8 të këtij ligji;**

14	28.9.2018	Kuršum Isufur me shpirtoruesit bashkë	13.9.2018	1. Aragon	Nuk ka
15	4.12.2018	Pezë Isufur me shpirtoruesit bashkë	12.12.2018	1. Aragon	Nuk ka
16	14.1.2019	Pezë Isufur me shpirtoruesit bashkë	27.12.2018	1. Aragon	Nuk ka

k) informacione dhe dokumente që kërkohen shpesh; Në faqen e autoritetit rezultojnë të publikua disa pyetje përgjigje, të cilat udhëzojnë të interesuarit lidhur me procedurat e autoritetit.

[illegible]

1) çdo informacion tjetër që gjykohet i dobishëm nga autoriteti publik. Në faqen e autoritetit rezultojnë të publikua disa fletëpalosje, të cilat udhëzojnë të interesuarit lidhur me procedurat e autoritetit.



Faqja zyrtare e autoritetit është përgjithësisht e pasur me informacion, por ky informacion është i publikuar menu të ndryshme të faqes dhe jo në përputhje me formatin e miratuar nga Komisioneri.

Autoriteti Publik	AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
Programi i transparencës	Po
Koordinatori	Po
7.1.a Përshkrim/ strukt, funk dhe detyr të A.P	Pjesërisht
7.1.b: Tekst. e plota të konventa, ligje, aktev	Po
7.1.c procedura për kërkesë për Inf.	Jo
7.1.ç Të dhënat e vendodhjes AP	Po
7.d Të dhënat për arsim, pagat	Jo
7.1.dh Auditi	Pjesërisht
7.1.e Buxheti	Jo
7.ë Procedura Prokurimit	Po
7.1.f Shërbimet e A.P	Po
7.1.g Procedura për ankesë për veprimtarinë e AP	Po
7.1.gj Mekanizma për dhënien e mendimeve	Jo
7.1.h Mbajtja e dok (Arkiva)	Jo
7.i Regjistri i kërkesave	Pjesërisht (i pa përditësuar)
7.1.k Dokumente që kërkohen shpesh	Po
7.1.l Çdo Informacion i dobishëm	Po